



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE**

PROJEKT VENDIM

Nr. ____ , Datë ____ / ____ /2025

PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL 2025-2028, TË BASHKISË Durrës

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligji nr.121, datë 21.11.2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Ligji Nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", Ligji 10221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Ligjin nr. 47/2018, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", Ligjin 65/2016, "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë", Ligjin 22/2018, "Për strehimin social", Ligjin 15/2019, "Për nxitjen e punësimit" dhe Ligjin 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës që në përputhje me aktet ligjore të shqyrtojë dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e Planit Social 2025-2028 të Bashkisë Durrës, bashkëngjitur këtij projektvendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social në Bashkinë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE

Drejtör

Alneida Rroshi

DREJTORIA SHËRBIMIT SOCIAL

Drejtör

Meme Xhaferaj

KRYETAR

Emiriana Sako



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL**

Nr. _____ prot.

Durrës, më ____/____/2025

RELACION

Për miratimin e Planit Social të Bashkisë Durrës

Mbështetur në Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr.121, datë 21.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në RSH”, Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2023–2030, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe angazhimet për integrimin në Bashkimin Evropian, Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashkëpunim me ekspertët kanë hartuar Planin Social 2025-2028 për Bashkinë Durrës.

Hartimi i planit është rezultat i një procesi pilot dhe inovator, ku Bashkia ka udhëhequr çdo fazë të përgatitjes: nga ngritja e strukturave drejtuese (Komiteti Drejtues dhe Grupi Teknik), te analizat e nevojave, prioritetet dhe konsultimet me komunitetin dhe aktorët lokal të arsimit, punësimit, formimit profesional, policisë dhe organizatave jofitimprurëse, që operojnë në territorin e bashkisë dhe bashkëpunojnë ngushtësisht me Bashkinë Durrës të mbështetur nga Bashkimit Evropian në kuadër të Programit për “Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (EU4SI), zbatuar nga GOPA Worldwide Consultants.

Ky dokument për bashkinë është plani i tretë social që Bashkia e Durrësit harton, në vazhdim të planeve sociale të mëparshme 2017-2020, 2021-2024, të cilët kanë vendosur themele të rëndësishme në kuadrin e ndërtimit të strukturave të shërbimeve shoqërore vendore, përmirësimit të shërbimeve ekzistuese e ndërtimit të shërbimeve të reja, si qendrave komunitare, shërbime për gratë e dhunuara e fëmijët në nevojë për mbrojtje, në bashkëpunim me palët e treta, disa prej tyre të mbështetura nga Fondi Social, përmes aplikimeve të projekteve të suksesshme.

Plani Social i Bashkisë Durrës 2025-2028 mbështetet në parime të forta si barazia, gjithëpërfshirja, transparenca, decentralizimi dhe vendimmarrja e bazuar në fakte. Përmes këtij dokumenti, Bashkia Durrës jo vetëm që adreson nevojat emergjente sociale, por forcon themelet për një model të qëndrueshëm e gjithëpërfshirës në ofrimin e shërbimeve sociale, me qytetarin dhe komunitetin në qendër.

Hartimi i këtij Plani Social Vendor për Bashkinë Durrës është ndërtuar mbi një diagnozë të detajuar të nevojave sociale në territor, duke evidentuar qartë sfidat, në mbështetjen e grupeve vulnerabël,

shpërndarjen e shërbimeve dhe kapacitetet institucionale ekzistuese. Ky proces analize përbën themelin për përcaktimin e prioriteteve dhe objektivave strategjike të planit.

Në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2023–2030, e cila synon ndërtimin e një sistemi social gjithëpërfshirës, reagues dhe të qëndrueshëm, Plani Social Vendor fokusohet në ndërhyrje që garantojnë barazi në akses, forcim të kapaciteteve lokale dhe përfshirje të qytetarëve në proceset sociale.

Tre prioritetet kryesore të Planit janë: forcimi i kapaciteteve dhe eficiencës së shërbimeve sociale; konsolidimi dhe zgjerimi i shërbimeve për grupet në nevojë; si dhe rritja e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes sociale, që janë të ndërlidhura ngushtë me parimet e Strategjisë Kombëtare dhe përbëjnë mekanizma konkretë për zbatimin e saj në nivel lokal.

Vizioni në këtë plan është shërbime shoqërore për një shoqëri gjithëpërfshirëse në Bashkinë Durrës, që fuqizon dhe mbështet çdo individ në nevojë për të jetuar një jetë dinjitoze, aktive dhe të pavarur. Me një misioni që Bashkia e Durrësit të ndërtojë dhe forcojë një sistem social të integruar dhe efikas, nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve profesionale, zgjerimit të shërbimeve për grupet vulnerabël dhe nxitjes së pjesëmarrjes aktive të komunitetit në proceset vendimmarrëse, duke promovuar barazinë, përfshirjen dhe fuqizimin social dhe ekonomik.

Objektivat dhe masat e përcaktuara në këtë plan synojnë të konkretizojnë vizionin e mbrojtjes sociale në nivel vendor, duke përmirësuar kapacitetin reagues të Bashkisë Durrës dhe të garantojnë mbështetje të qëndrueshme, të barabartë dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë qytetarët në nevojë.

Përmbushja e Vizionit dhe Misionit të Planit Social është parashikuar me arritjen e tre prioriteteve kryesore: forcimi i kapaciteteve dhe eficiencës së shërbimeve sociale; konsolidimi dhe zgjerimi i shërbimeve për grupet në nevojë; si dhe rritja e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes sociale, të cilat prezantohen në plan të shoqëruar me objektivat e lidhura me çdo masë dhe aktivitetet për realizimin e tyre dhe aktorët përgjegjës.

Bashkia Durrës do të ndërtojë strukturat e nevojshme për ofrimin e shërbimeve shoqërore në nivelin e njësisë administrative, përmes ngritjes së strukturës koordinuese në nivel drejtorie, punësimit të punonjësve socialë në çdo njësi dhe ngritjen e skuadrave të njësisë të vlerësimit nevojave dhe referimit (NJVNR).

DREJTORE

Meme Xhaferaj